



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1862/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P “T...” sh.a, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.628/2021 të datës 29.12.2021 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 27.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.628/2021 të datës 29.12.2021 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.628/2021 të datës 29.12.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “T...” sh.a, me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik IV. Ek.C.nr.231/19 i dt. 02.06.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamenti për Çështje Ekonomike Ae.nr.195/21 të dt. 25.11.2021, ka nxjerrë urdhrin P.nr.628/2021 të datës 29.12.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit, ndaj debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës duke detyruar debitorin që të paguaj në emër të borxhit shumë prej 603.595.20 €, me kamatë ligjore të cilat e aplikojnë bankat në afat prej një viti pa destinim të caktuar nga dt. 18.01.2010 deri në pagesën definitive, si dhe

shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,978.00 € dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në përputhje me tarifat e Përmbauesve Privat.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se kreditori nuk ka pasur të drejtë të kërkoj përbarimin pasi që ende nuk ka kaluar afati paritiv i përmbushjes së detyrimit dhe se i njëjti ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme, duke i propozuar gjykatës që ta anuloj urdhrin e Përmbauesit Privat P.nr.628/21 si të pa bazuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në ligj dhe ka për qëllim vetëm prolongimin e procedurës, ka shtuar se kanë kaluar të gjitha afatet dhe se po të mos kishin kaluar afatet kreditori nuk do të kishte mundësi ta vuloste aktgjykimin e shkallës së parë me plotfuqishmëri dhe ekzekutueshmëri. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të anulohet dhe borxhi në vlerë prej 603.595.20 euro, të ekzekutohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përbarimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbauesit Privat P.nr.628/2021 të datës 29.12.2021, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përbarues (titullit ekzekutiv) – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik IV. Ek.C.nr.231/19 i datës 02.06.2021, i cili është ndryshuar pjesërisht dhe është vërtetuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamenti për Çështje Ekonomike Ae.nr.195/21 të datës 25.11.2021.

Sipas dokumenti përbarues - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike IV. Ek.C.nr.231/19 i datës 02.06.2021, debitori është detyruar që kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumë prej 603.595.20 € duke filluar prej datës

22.06.2000 e deri më datën 31.12.2003 me kamatë vjetore prej 3.5%, prej datës 18.03.2010 si dhe t'ia kompensoj kreditorit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,978.00 €. Ndërsa sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamenti për Çështje Ekonomike Ae.nr.195/21 të datës 25.11.2021, është refuzuar si e pa themeltë ankesa e debitorit dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike IV. Ek.C.nr.231/19 i datës 02.06.2021, përveç në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë është ndryshuar dhe është detyruar debitori që të paguaj kamatën ligjore siç e aplikojnë bankat të cilat operojnë në Kosovë, me deponim të mjeteve në bankë, në afat prej 1 viti pa destinim të caktuar duke filluar nga dt. 18.01.2010 e deri në pagesën definitive.

Gjykata vlerëson se dokumenti përmbarimor – aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik IV. Ek.C.nr.231/19 i dt. 02.06.2021 i formës së prerë nga dt. 25.11.2021 dhe i ekzekutueshëm nga dt. 20.12.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit – Departamenti për Çështje Ekonomike Ae.nr.195/21 i datës 25.11.2021, janë dorëzuar në origjinal dhe si të tilla i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit–vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”.*

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja*

e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, dhe i njëjti është i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim, pasi që në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti lidhur me këtë çështje juridike, ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë nuk gjen mbështetje ligjore, ngase bazuar në dispozitën e nenit 213 të LPK –së, me të cilën është përcaktuar se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*, rezulton se paraqitja e revizionit si mjet i jashtëzakonshëm juridik, nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1862/22, datë 27.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve

nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.